REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANIMA
Sh. U. 02 Nr. Br. 31656
Nr. i faq. Br. str. 2 Data: Datum: 12/11 2025
KAMENICË

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Komuna e Kamenicës**

Mbështetur në nenin 26 paragrafi 1 dhe 2 nënparagrafi 2.4 të Rregullores Sh.01.Nr.31251 e datës 29.09.2022 së Komunës së Kamenicës për Kushtet Kriteret dhe Procedurën e Ndarjes së Subvencioneve, si dhe neni 5, paragrafi 5.1, shkronja j), neni 70, paragrafi 70.1, shkronja b), dhe neni 82 i Statutit Sh.02.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Komuna e Kamenicës shpallë:

# THIRRJE PUBLIKE

## PËR SUBVENCIONIM ME "BABY BOX" (PAKO ME RROBA DHE PRODUKTE TË RËNDËSISHME PËR FOSHNJE)

Në kuadër të politikave komunale për përmirësimin e mirëqenies familjare dhe mbështetjen e nënës, foshnjës dhe familjeve të reja, Komuna e Kamenicës shpall këtë Thirrje Publike për subvencionim me "Baby Box" – pako ndihmëse për nënat dhe prindërit e rinj të fëmijëve të porsalindur.

Ky program synon të ofrojë mbështetje materiale për gratë shtatzëna dhe lehonat, duke kontribuar në krijimin e kushteve sa më të mira për jetën e foshnjës dhe përmirësimin e kushteve të kujdesit prindëror.

### 1. Qëllimi i subvencionit

"Baby Box" përmban artikuj bazë të kujdesit për foshnjën dhe nënën, të cilët ndihmojnë prindërit në ditët e para pas lindjes dhe gjatë muajve të parë të jetës së foshnjës.

Përmbajtja përfshin:

- Rroba për foshnjën e porsalindur;
- Produkte për kujdesin dhe higjienën e foshnjës;
- Produkte për kujdesin e nënës pas lindjes.

## 2. Kriteret e aplikimit

Për të përfituar nga kjo thirrje, prindërit duhet të plotësojnë këto kushte:

• Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
• Të jenë banorë të Komunës së Kamenicës;
• Në rastin e gruas shtatzënë, shtatzënia të jetë nga java e 27-të e tutje;
• Në rastin e lehonës, periudha të jetë deri në 40 ditë pas lindjes së foshnjës.

## 3. Dokumentacioni i nevojshëm

Për aplikim, njëri prej prindërve dorëzon kërkesën, të shoqëruar me dokumentacionin e detyrueshëm përkatës;

- Kopje të letërnjoftimit për të dy (2) prindërit;
- Certifikatën e vendbanimit për të dy (2) prindërit;
- Deklaratën e bashkësisë familjare;
- Raportin mjekësor nga mjeku specialist/gjinekologu (për gratë shtatzëna);
- Ekstraktin e lindjes për të porsalindurin (për lehonat).

## 4. Afati dhe mënyra e aplikimit

Thirrja publike është e hapur pa afat të caktuar kohor, deri në përfundimin e sasive të parashikuara në kuadër të buxhetit dhe kontratës. Përfundimi i thirrjes publike do të bëhet me njoftim zyrtar nga Komisioni kompetent.

Aplikimi mund të bëhet nga njëri prej prindërve të fëmijës, në përputhje me kriteret dhe dokumentacionin e kërkuar në këtë thirrje.

Aplikimet pranohen në Qendrën për Shërbime me Qytetarët, në objektin e Komunës së Kamenicës, gjatë orarit të rregullt të punës.

Përzgjedhja dhe verifikimi i përfituesve bëhet nga Komisioni Vlerësues, i emëruar me vendim të Kryetarit të Komunës, në përputhje me kriteret e përcaktuara dhe dokumentacionin e dorëzuar.

**Kryetari i Komunës**

**Kadri Rahimaj**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHERBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 02 Nr. Br. 31656
Nr. i faq. Br. str. 2 Data: Datum: 12/11/2025
KAMENICË

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

**Opština Kamenica**

Na osnovu člana 26 stav 1 i 2 podstav 2.4 Pravilnika Opštine Kamenica o Uslovima, Kriterijumima i Postpucima za Dodelu Subvencija, Š 01, Br.31251 od/datum 29.09.2022, kao i člana 5, stav 5.1, slovo j), član 70, stav 70.1, slovo b), i člana 82 Statuta Opštine Kamenica, Š 02, Br.20203 od/datum 21.06.2023, Opština Kamenica objavljuje:

**JAVNI POZIV**

**ZA SUBVENCIJE ZA "BEBI KUTIJE" (PAKETIMA ODEĆOM I VAŽNIM PROIZVODIMA ZA NOVOROĐENČAD)**

U okviru opštinskih politika za poboljšanje porodičnog blagostanja i podrške majci i novorođenčad kao i drugim porodicama, Opština Kamenica objavljuje ovaj Javni Poziv za subvencije sa "Bebi Kutijama" – pomoćni paketi za majke i mlade roditelje za novorođenčad.

Ovaj program teži pružati materijalnu podršku za trudnice i majke, doprinoseći stvaranju najboljih mogućih uslova za život novorođenčeta i u poboljšanju uslova roditeljske brige.

**1. Svrha subvencije**

"Bebi Kutija" sadrži osnovne stvari za negu novorođenčadi i majku, koji pomažu u prvim danima nakon rođenja i tokom prvih meseci života novorođenčadi.

Sadržaj uključuje:

- Veš za novoređenčad;
- Proizvodi za negu i higijenu novorođenčeta;
- Proizvodi za brigu majke nakon rodenja.

## 2. Kriterijumi za prijavu

Da bi se uključili u ovaj poziv, roditelji moraju da ispunjavaju sledeće uslove:

• Da je državljanin Republike Kosova;
• Da je stanovnik Opštine Kamenica;
• Kod slučaja trudnice, trudnoća mora biti od 27 nedelje pa nadalje;
• Kod slučaja porodilje, period je da je do 40 dana nakon rođenja novorođenčeta.

## 3. Potrebna dokumentacija

Za prijavu, jedan od roditelja dostavlja zahtev, u prilog sa važećom obaveznom dokumentacijom;

- Kopija lične karte za oba roditelja;
- Uverenje prebivališta za obe roditelje;
- Izjava porodične zajednice;
- Izveštaj lekara specijaliste/ginekologa (za trudnice);
- Ekstrakt rođenih za novorođeno dete porodilje).

## 4. Rok i način prijave

Javni poziv je otvoren bez određenog vremenskog roka, do završetka predviđenih količina u okviru budžeta i ugovora. Javni poziv će biti završen zvaničnim obaveštenjem od nadležne Komisije.

Prijavu može podneti jedan od roditelja deteta, u skladu relevantnih kriterijuma i dokumentacije koja je zahtevana u ovaj poziv.

Prijave se primaju u Centru za Usluge Građanima, u objektu Opštine Kamenica, tokom redovnog radnog vremena.

Izbor i verifikaciju korisnika vrši Komisija za evaluaciju, imenovana odlukom Predsednika Opštine, u skladu sa utvrđenim kriterijumima i dostavljene dokumentacije.

**Predsednik Opštine**

**Kadri Rahimaj**